



01 Nr. 658/24 Dt. 24.10.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Teatrit të Qytetit “Bekim Fehmiu”, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M Për lejimin e mjeteve

1. Miratohet kërkesa e Teatrit të Qytetit “Bekim Fehmiu” në Prizren, për lejimin e mjeteve financiare për pagesën (honorarët) për të angazhuarët e jashtëm për shfaqjen teatrale “Ping Pong dhe Dashuri”, të autorit dhe regjisorit Butrint Paha, kështu që, në emër të pagesës së angazhimit, lejohen mjetet e nevojshme financiare për secilin prej të angazhuarave të jashtëm si në vijim për:
 - 1.1. Butrint Pasha-autor dhe regjisor, lejohen mjetet në shumën prej 4500 € (katërmijë e pesëqind euro),
 - 1.2. Adhurim Grezda-kompozitor, lejohen mjetet në shumën prej 2.000 € (dymijë euro),
 - 1.3. Blin Mani, aktor i jashtëm, lejohen mjetet në shumën prej 2.880 € (dymijë e tetëqind e tetëdhjetë euro),
 - 1.4. Doruntina Basha, konsulentë e dramaturgisë, lejohen mjetet në shumën prej 600 (gjashtëqind euro),
 - 1.5. Petrit Bakalli-stenograf dhe realizues i stenografisë, lejohen mjetet në shumën prej 3.500 € (tremijë e pesëqind euro),
 - 1.6. Alma Krasniqi, kostumografe dhe realizuese e kostumeve, lejohen mjetet në shumën prej 3.000 € (tremijë euro),
 - 1.7. Skender Latifi –dizajner i ndriçimit, lejohen mjetet në shumën prej 800 € (tetëqind euro),
 - 1.8. Gëzim Sertollaj-koreograf i ushtrimeve plastike, lejohen mjetet në shumën prej 1.130 € (njëmijë e njëqind e tridhjetë euro),
 - 1.9. Ender Shaljani-xhirues dhe fotograf i shfaqjes, lejohen mjetet në shumën prej 800 € (tetëqind euro),
 - 1.10. Arshi Shaljani-dizajner grafik, lejohen mjetet në shumën prej 800 € (tetëqind euro),
 - 1.11. Canan Güner-grimere, lejohen mjetet në shumën prej 980 € (nëntëqind e tetëdhjetë euro).
 2. Shuma e përgjithshme që lejohet është 20.990 € (njëzetmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë euro).
 3. Shuma e lejuar, e përshkruar si në këtë Vendim, do të sigurohen nga buxheti i Komunës pozicioni i subvencioneve dhe transfereve -kodi nga Teatri i Qytetit (nr. 85157).
 4. Obligohet Teatri i Qytetit dhe Drejtoria për Ekonomi dhe Financa për zbatimin e këtij vendimi.
 5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.
- Vendimi iu dërgohet:
- Teatrit të Qytetit,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Arkivës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj